


## Mjetet e sistemit(System tools)

Start

All programs

Accessories

System tools



**Disk cleanup** - Mundeson reduktimin e numrit te fajllave te panevojshem ne PC duke krijuar me shume hapesire te lire ne hard disk.Kjo perfshin **delete temporary files**, boshatisjen e **recycle bin**, fshirjen e **system files** qe nuk nevojiten me si dhe fshirjen e **restore points** te panevojshem.

**Disk defragmenter** - Eshte nje mjet i windowsit i cili sherben per te rritur eficencen e hard diskut.Gjate funksionimit te PC krijohen fragmente(copezime) te fajllave gje e cila ndikon negativisht ne performancen e sistemit duke cuar ne ngadalesimin e tij.Ky mjet riorganizon pozicionimin e fajllave brenda hard diskut duke i rigrupuar ato sa me prane njera tjetres.

**System restore** - Perdor **restore points** per te kthyer **system files,programet** dhe **system settings** ne nje kohe te meparshme pa prekur te dhenat.Gjithashtu mund te krijohet nje restore point ne menyre manuale

**Task scheduler** - Mundeson ekzekutimin e nje programi ne nje kohe te caktuar ne menyre automatike

**System information** - Jep detaje ne lidhje me konfigurimin e harduerit te PC,komponentet harduerike,versionin e sistemit te instaluar etj.

**Resource monitor** - Eshte nje mjet qe tregon shkallen e perdorimit te CPU,Ram-it ,hard diskut dhe network-ut ne kohe reale

**Windows easy transfer** - Mundeson transferimin e fajllave folderave dhe program settings nga nje kompjuter ne nje tjeter

- user accounts
- documents
- music
- pictures
- e-mail
- Internet favorites
- program settings